





Republika e Kosovës




Kuvendi i Komunës- Vushtrri

Bazuar në nenin 40.2 "c" dhe nenin 17 pika "k" të Ligjit Nr.03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale dhe nenin 40.2 "dh" dhe 41.2 "ç" të Statutit të Komunës, si dhe në bazë të propozimit të Kryetarit të Komunës së Vushtrrisë Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më **29 shtator 2015** mori këtë:

VENDIMI
PËR OFRIMIN E NDIHMËS FINANCIARE PËR QENDREN PËR MBROJTEJN E GRUAS DHË FËMIJËS "RABA VOCA"

- 1.Me këtë vendim lejohen mjetet buxhetore për ofrimin e ndihmës financiare Qendrës për Mbrojtjen e Gruas dhe Fëmijës "Raba Voca" në vlerën prej 2,508.80€, nga kategoria subvencione dhe transfere (subvencione për raste të veçanta), nga zyra e kryetarit, për vitin 2015 për subvencionimin e një pjese të shpenzimeve të kësaj qendre.
- 2.Shuma e mjeteve financiare të cekura në pikën 1 të këtij vendimi ndahet për mbulimin e shpenzimeve për Qendrës për Mbrojtjen e Gruas dhe Fëmijës "Raba Voca" për pagesën e qirasë, energjisë elektrike dhe shërbimeve tjera publike.
3. Qendrës për Mbrojtjen e Gruas dhe Fëmijës "Raba Voca" i ndahen mjetet financiare për vitin 2016, në vlerën prej 3,834.88€ nga kategoria subvencione dhe transfere për mbulimin e shpenzimeve për ushtrim të veprimtarisë së kësaj qendre.
- 4.Obligohet Kryetari i Komunës që të nënshkruaj Memorandumin e Mirëkuptimit me Komunën e Mitrovicës së Jugut dhe Komunën e Skenderajt për subvencionim të përbashkët të qendrës në fjalë.
- 5.Për zbatimin e këtij Vendimi obligohet: kryetari i komunës dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
- 6.Ky Vendim hyn në fuqi 8 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Kryesuesi i Kuvendit


Shpëtim Zhegrova

